

VENDIM
Nr. 398, datë 8.5.2013

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA SISTEMIMI, ASFALTIMI,
NDËRTIMI I TROTUAREVE DHE NDRIÇIMI RRUGOR I BLOKUT NR. 4, NË QYTETIN E
FUSHË-KRUJËS, NË BASHKINË E FUSHË-KRUJËS TË QARKUT TË DURRËSIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga sistemimi, asfaltimi, ndërtimi i trotuarëve dhe ndriçimi rrugor i bllokut nr. 4, në qytetin e Fushë-Krujës, në bashkinë e Fushë-Krujës të qarkut të Durrësit.

2. Pasuritë, në sipërfaqen prej 24 (njëzet e katër) m² objekt, pronë private që shpronësohet, si dhe pronarët që shpronësohen, janë sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë pronë private të të cilëve shpronësohen, është 518 400 (pesëqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë. Vlera e përgjithshme e shpronësimit përballohet nga buxheti i bashkisë së Fushë-Krujës.

4. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Fushë-Krujës.

6. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Fushë-Krujës për realizimin e këtij projekti.

7. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Fushë-Krujës. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 24 (njëzet e katër) m² objekt, shpronësuar në favor të bashkisë së Fushë-Krujës, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Ngarkohen bashkia e Fushë-Krujës dhe Ministria e Brendshme për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha